

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2466/1 datë 12.6.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3137/4 datë 29.7.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 6-të mbajtur më 29.7.2025, miratoi sa vijon:

**Aktvendim
për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e kryer të nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), për shkak se në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 3 qershor 2025, reklamë për kompaninë "Alba Bridges", është transmetuar burimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe dhe maqedonisht, gjuhë në të cilat media transmeton programe në përputhje me lejen PA! Nr.08-353 datë 30.06.2016.

Shkelja në paragrafin (1) të kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2466/1, datë 12.6.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. URDHËROHET që SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 64, paragrafi (1) të LSHMAAV, radiodifuzerët janë të detyruar të transmetojnë programin në gjuhën maqedonase dhe shkrimin cirilik, ndërsa në rastet kur programi është destinuar për bashkësi jo shumicë, dhe në gjuhën dhe shkrimin e kësaj bashkësie.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 12 qershor 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, transmetuar më 3 qershor 2025, në nivel lokal, ku është konstatuar shkelje e nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se më 3 qershor 2025, në shërbimin programor televiziv të SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, është transmetuar reklamë për kompaninë "Alba Bridges", burimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe ose maqedonisht, gjuhë pë të cilin mediumi transmeton programe në përputhje me PA1 nr.08-353 datë 30.6.2025.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2466/1 datë 12.6.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, më 13.6.2025, dërgoi Shkresë ark.nr.10-2466/2 datë 13.6.2025, me të cilën dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2466/1 datë 12.6.2025, me

qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të shkrësës, drejtuar Këshillit të Agjencisë t'i dorëzon deklaratë me shkrim në lidhje me shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 19.6.2025, për të cilën në afatin e parashikuar SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 6-të mbajtur më 29.7.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë, t'i shqiptohet masë - paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 64 paragrafët (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2466/1 datë 12.6.2025,dhe Konkluzionin ark.nr.02-3137/4 datë 29.7.2025 për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 29.7.2025, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TELEVISION USKANA MEDIA SHPKNJP Kërçovë dhe urdhëron që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, është marrë aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2466/1 datë 12.6.2025.

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho STEFANOVSKI**

Këshillë ligjore: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.